

**Në bazë të nenit 51, të Statutit të Federatës së Çiklizmit të Kosovës, Bordi i Federatës në mbledhjen e vetë të rregullt të mbajtur më 19.11.2022 nxjerr:**

**RREGULLOE PËR REGJISTRIMIN, LICENCIMIN E  
KLUBEVE, SPORTISTËVE, TAJNERËVE TË  
ÇIKLIZMIT**

**Prishtinë 19.11.2022**

# DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

(principet bazike të punës së klubeve të çiklizmit )

1. Kjo rregullore përcakton kushtet për funksionimin e klubeve të çiklizmit, si dhe kriteret për të marrë të drejtën për të punuar në fushën e çiklizmit, në Kosovë.
2. Aktivitetet në fushën e çiklizmit, të cilat janë në përgjegjësinë e Federatës, mund t'i realizojnë vetëm klubet që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare pranë ministrisë gjegjëse dhe të cilat i plotësojnë standardet e përcaktuara në këtë Rregullore.
3. Klubet e çiklizmit, mund të kryejnë aktivitete sportive dhe veprimtari sportive në qoftë se, në përputhje me Ligjin e sportit, Statutin e FÇK dhe rregulloret e FÇK kanë:
  - a) çiklist ,të anëtarësuar në klub ;
  - b) Trajner të çiklizmit, të angazhuar, në varësi të llojit të veprimtarisë;
  - c) të siguroj pajisje dhe rekuizita për trening dhe gara ;
  - d) organizim të brendshëm të përshtatshëm dhe burime financiare për të marrë pjesë në aktivitetet çiklizmit, .

## NENI 1

### REGJISTRIMI I KLUBEVE PËR HERË PARË

1. Çdo klub i çiklizmit, që dëshiron të bëhet anëtar i FÇK-së duhet të bëjë kërkesë me shkrim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të FÇK-së. Sekretari i Përgjithshëm i konfirmon kandidatit paraqitjen e kërkesës te komisioni.
2. Kërkesa duhet të shoqërohet detyrimisht me dokumentet e mëposhtme:
  - a) Certifikata e OJQ kopje
  - b) Vërtetimi për regjistrim e klubit në Komunën përkatëse.
  - c) Vërtetim të personit të autorizuar të klubit nga OJQ, dëshmi që personi i autorizuar nuk bie ndesh me ligjin.
  - d) Një kopje të vlefshme të stautit konfor statutit të FÇK
  - e) Një kopje të vlefshme të rregulloren e kuvendit
  - f) Një kopje të vlefshme të rregulloren e bordit
  - g) Një kopje të vlefshme të rregulloren disiplinore
  - h) Klubi duhet të ketë llogari bankare aktive.
  - i) Klubi duhet të ketë logon e saj.
  - j) Klubi duhet të ketë flamurin e saj.
  - k) Klubi duhet të ketë vulën e saj.
  - l) Klubi duhet të ketë trajner të licencuar nga FÇK, apo profesor të Edukatës Fizike.
  - m) Një deklaratë ku klubi angazhohet se do të veprojë në përputhje me statutin, rregulloret dhe vendimet e FÇK-së, së, UCI-s dhe UEC -s dhe të sigurojë që këto dokumente do të respektohen gjithashtu, nga anëtarët e klube, zyrtarët dhe çiklistet , triatletët e tij/ saj (nëse është e zbatueshme);
  - n) Një deklaratë ku klubi angazhohet se do të veprojë në përputhje me rregulloren e garave në fuqi, siç përcaktohet nga UCI ,FÇK.
  - o) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do t'i drejtohet si shkallë e fundit (d.m.th. pas shterimit të të gjitha forumeve të brendshme të FÇK-së) për çdo

mosmarrëveshje të dimensionit kombëtar që lind ose lidhet me statutin, rregulloret, direktivat dhe vendimet e FÇK-së vetëm te CAS në Kosovë.

p) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se përbërja e tij ligjore garanton se ai mund të marrë vendime në mënyrë të pavarur nga ndonjë subjekt i jashtëm dhe të sigurojë që çështjet e tij të mos ndikohen në mënyrë të papërshtatshme nga ndonjë palë e tretë, në veçanti që ai është i pavarur nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;

q) Një deklaratë ku shprehet se anëtarët e organeve të veta janë zgjedhur ose emëruar si rezultat i një procedure që garanton pavarësinë e plotë të zgjedhjeve ose emërimeve, nga çdo ndërhyrje apo ndikim politik i papërshtatshëm;

r) Një listë të zyrtarëve, duke specifikuar ata që janë përfaqësues ligjorë, me të drejtë të lidhin marrëveshje ligjërish të detyrueshme me palë të treta;

s) Një kopje të procesverbalit të Kuvendit të fundit ose të mbledhjes themeluese;

t) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se ai merr përsipër të organizojë ose të marrë pjesë në ndonjë garë ndërkombëtare ,mund të marrë pjesë vetëm me pëlqimin paraprak të FÇK-së (nëse aplikohet)

u) Klubi ne kuvendin themelues duhet ta ftoj FÇK për monitorimin e kuvendit te klubit, qoftë zgjedhor, apo kuvend i punës, i rregullt apo i jashtëzakonshëm.

v) Një deklaratë ku kandidati angazhohet se do të marrë pjesë në garat zyrtare me reprezentacionin e Kosovës, përveç nëse vendoset ndryshe nga autoritetet kompetente (nëse aplikohet).

## **NENI 2**

### **KËRKESA DHE PROCEDURA E APLIKIMIT**

Komisioni së bashku me Sekretarin i Përgjithshëm verifikon përmbushjen e kërkesave të parashikuara me statut dhe përgatit një raport me shkrim për Bordit.

Bordi do të shqyrtojë raportin me shkrim dhe do të vendosë nëse kërkesa për anëtarësim i plotëson të gjitha kërkesat sipas statutit të FÇK,

Bordi e pranon anëtarin me te drejta të përkohshme.

### **NENI 3 PËRJASHTIMI**

1. Përjashtimi i një anëtar bëhet nëse:
  - a) Shkel rëndë dhe në mënyrë të përsëritur statutin, rregulloret ose vendimet e UCI-t, UEC-s dhe FÇK-së;
  - b) Nuk arrin të përmbushë kërkesat e anëtarësimit të përcaktuara në këtë statut;
  - c) Nuk arrin të përmbushë detyrimet e tij financiare ndaj FÇK-së;
  - d) Nëse vërtetohet se Anëtari ka pushuar së vepruari;
  - e) Me fshirjen nga regjistri i Anëtarëve aktual;
  - f) Me kërkesën personale me arsyetimin me shkrim;
  - g) Me vendimin e Kuvendit të FÇK-së;
2. Bordi ka të drejtë vetëm të propozojë përjashtimin e një anëtari.

### **NENI 4**

#### **LICENCIMI I KLUBEVE TË ÇIKLIZMIT**

1. Kjo Rregullore parashikon licenca për klubet çiklizmit
2. Leja e punës (licenca) i lëshohet klubit çiklizmit për një periudhë jo më të gjatë se një vit (për sezonin e garave kombëtare), me të cilën me datën që përfundon vlefshmërinë e lejes së punës (licencës) gjithmonë përkon me përfundimin e sezonit të garave kombëtare - të viti për të cilin është lëshuar leja e punës (licenca).

### **NENI 5**

Klubi i çiklizmit merr një licencë kur ai plotëson kushtet në vijim:

1. Regjistron në Federatë të paktën 5 (pesë) çiklist te grupmoshave te ndryshme dhe marrin pjesë në gara.
2. Merr pjesë në garat çiklizmit në vend së paku 3 gara.
3. Angazhon trajner sportiv si vijon:
  - Të paktën (1) me një licencë bazë të lëshuar nga FÇK apo UCI;
4. Siguron pajisje të përshtatshme sportive dhe rekuizita sportive në përputhje me standardet e përcaktuara sipas rregullave të garave për çiklizmit nga UCI

dhe FÇK për të realizuar veprimtarinë e tij.

5.. Shlyen të gjitha detyrimet financiare në përputhje me vendimet e bordit të FÇK-së(të licencimit, kotizimit, regjistrimit etj.).

6. Kryen procesin e trajnimit me triatletet me trajner.

## **NENI 6**

### **PROCEDURAT E LICENCIMIT TË KLUBEVE ÇIKLIZMIT**

(Procedura e Licencimit dhe përbërja e Komisionit për licencim)

1. Procedurat e Licencimit i kryer Komisioni për licencim të klubeve të FÇK-së(në tekstin e mëtejme Komisioni).

2. Mandati i Komisionit është katër (4) vjet.

3. Punët teknike të Komisionit i kryen Sekretari i Komisionit të cilin e emëron Sekretari i Përgjithshëm i FÇK.

-Sekretari i Komisionit mbledhë dokumentacionin, mbajë evidencë për licencat e lëshuara dhe aplikacioneve të refuzuara, informon klubet me vendimet e Komisionit.

4. Anëtarët e Komisionit do të ketë të drejtë për kompensim të shpenzimeve për punën e tyre. Për lartësinë e kompensimit vendos Bordi i FÇK.

## **NENI 7**

### **(DOKUMENTACIONI PËR LICENCIMIN E KLUBEVE ÇIKLIZMIT)**

1. Dokumentacioni i plotë në procesin e licencimit të klubeve çiklizmit duhet të përmbajë:

- Kërkesa për dhënien e licencës e plotësuar në formën e përcaktuar (Formulari 1);

- Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së të klubit çiklizmit;

- Listën e triathletëve të regjistruar me numrat e librezës së identitetit të garave për vitin për të cilin kërkohet licenca (Formulari 2);

- Listën e trajnerëve te klubit;

- Dëshmi për hapësirë për kryerjen e aktiviteteve sportive

- Fotokopje të dëshmive të detyrimeve të shlyera financiare ndaj vendimeve të FÇK,

- Dëshmi mbi pagesën e shpenzimeve të procesit të licencimit, të cilat janë paguar në xhirollogarinë e Federatës çiklizmit të Kosovës (kopje e pagesës).

## NENI 8

### PROCEDURAT E LICENCIMIT DHE ANKESAT NË VENDIM

1. Procedura e dhënies së licencave (e lejes së punës) të klubit çiklizmit, pavarësisht licencës, do të kryhet si më poshtë:
  - a. Klubi çiklizmit i cili dëshiron të kryej aktivitete sportive dhe veprimtari sportive, kërkesën e tij për licencë me dokumentacionin përkatës (formularin e vërtetuar me vulën e klubit dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi zyrtar i klubit dhe dëshmi të dokumentuara), i paraqet në zyrën e federatës, e cila zyrtarisht e përcjellë më pas tek Komisioni për procedurë të mëtutjeshme.
  - b. Dokumentet i shqyrton dhe analizon anëtarët e Komisionit në përputhje me standardet e përshtuara në këtë Rregullore. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës dhe e urdhëron atë për të përfunduar atë brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit. Në qoftë se deri në atë datë dokumentacioni nuk është i plotë, kërkesa për licencë refuzohet.
  - c. Komisioni do të shqyrtojë vetëm dokumentacionin e plotë brenda një periudhe prej 30 ditësh nga kompletimin e dokumentacionit.
  - d. Federata e çiklizmit e Kosovës parashtruesit të kërkesës, të cilit i është miratuar licenca, i jep lejen për punë (licencën) të nënshkruar nga ana e personi i autorizuar të FÇK.
2. Në rastet kur kërkesa është refuzuar, Komisioni do të informojë parashtruesin e kërkesës, duke shpjeguar arsyet për mos dhënien e licencës dhe një mjet juridik (shkresë).
3. Në vendimin e Komisionit parashtruesi i kërkesës i cili nuk ka marrë lejen për punë, ka të drejtë të ankohet te komisioni i ankesave të FÇK-së dhe brenda 8 ditëve nga dita e pranimit të vendimit. Komisioni i Ankesave i FÇK-së ose mund të refuzojë apo të pranojë ankesën.
4. Në rast se Komisioni sërish vendos që një aplikant për licencë nuk i plotëson

kushtet për marrjen e licencës, aplikanti (parashtruesi) për licencë ka të drejtë të ankohet në Cas ne Kosovë brenda 8 ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

## **NENI 9**

### **PAMJA DHE PËRMBAJTJA E LICENCËS LEJES PËR PUNË TË KLUBIT ÇIKLIZMIT**

1. Leja e punës (licenca) e klubit çiklizmit lëshohet (jepet) në letër 100 gram në format A-4. Ajo shtypet me shkronja të zeza në sfond të ndryshme të ngjyrosur të tillë si:

- Licenca ne sfond broz

2. Leja për punë e klubit çiklizmit, detyrimisht duhet të përmbajë:

- Emri i plotë i klubit në bazë të Certifikatës së OJQ-së;

- Emri i licencës – Klub i Licencuar;

- Periudha për të cilën është lëshuar (datën e lëshimit dhe data e skadimit):

- Licenca duhet të përmbajë nënshkrimin original të personit të autorizuar dhe vulën FÇK.

## **NENI 10**

### **NDËRPRERJA E VLEFSHMËRISË RIPËRTRIRJA DHE MARRJA E LICENCËS**

(Kohëzgjatja dhe përtëritja e licencës)

1. Leja për punë (Licenca) automatikisht ndërpritet të vlejë në datën e përfundimit të periudhës për të cilën është lëshuar.

2. Klubi çiklizmit ka për detyrë që Komisionit për licencim të klubeve të FÇK-së t'i kërkoj zgjatjen e të njëjtës ose lëshim të tjetrës 30 ditë para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

3. Klubi çiklizmit i cili është licencuar dhe nëse nuk ka asnjë ndryshim në kushtet e angazhimit të triathletëve ose profesionistëve sportive (ka kontratë shumëvjeçare), ose nuk ndryshon hapësirën ku i kryen aktivitetet sportive (ka



kontratë shumëvjeçare) paraqet vetëm kërkesën për ripërtëritje të licencës (Formulari 1).

4. Komisioni në detyrën zyrtare mbi bazën e dokumentacionit zyrtar dhe regjistrimit i cili bëhet në Federatë vërteton nëse tek parashtruesi i kërkesës për licencë, e ka dokumentacionin në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

5. Nëse Komisioni për licencim brenda 30 ditëve nuk jep përgjigje në kohë në kërkesën e bërë apo tejkalon periudhën maksimale për licencë të mëparshëm të vlefshme, klubi çiklizmit ka të drejtën për të vazhduar për të ndjekur aktivitetet që u janë lejuar në licencën e skaduar, deri në momentin e ripërtëritjes së licencës.

## **NENI 11**

### **MARRJA E LICENCËS**

1. Leja e punës (licenca) i merret klubit çiklizmit kur në bazë të dokumenteve zyrtare të mbajtura në regjistrat e Federatës vërtetohet se:

- Gjatë punës në lëmin e çiklizmit, klubi kryen edhe detyra të cilat nuk janë të përshkruara në llojin e licencës së lëshuar;

- Nëse vërtetohet më vonë se është dorëzuar dokumentacion i rremë apo i falsifikuar

mbi të cilat është lëshuar leja për punë (licenca);

- Në qoftë se gjatë afatit të licencës janë humbur kushtet e kërkuara për posedim të një licence të lëshuar siç kërkohet sipas kësaj rregulloreje;

- Në qoftë se me aktivitetet e klubit dëmtohet reputacioni i Federatës çiklizmit të Kosovës dhe përdoren mjete mashtruese dhe të paligjshme;

- Në qoftë se klubi është suspenduar ose pushon së punuari me ndonjë bazë ligjore.

-Nëse klubi nuk merr pjese në gara ashtu siç parashihet me këtë rregullore.

-Nëse klubi nuk kryen treningë javore me çiklistet e saj.

-Nëse klubi vërtetohet se nuk mban asnjë seancë stërvitore gjatë vitit.

-Nëse zyrtaret e Klubit demtojnë reputacionin e FÇK.

-Nëse zyrtarët e klubit, çiklistet, trajnerët nuk e respektojnë Statutin dhe rregulloret e FÇK.

2. Në faqen zyrtare të Federatës çiklizmit të Kosovës publikohet emri i klubit çiklizmit të cilit i është marrë leja për punë (licenca), pas vendimit përfundimtar.

## **NENI 12**

### **SHPENZIMET E LICENCIMIT**

(Pagesa e shpenzimeve)

1. Bordi i FÇK-së e përcakton shumën e shpenzimeve të lëshimit dhe ripërtëritjes së licencës.
2. Shpenzimet e licencimit, të paguhen në Federatën e çiklizmit.

## **NENI 13**

### **PARAQITJA DHE REGJISTRIMI-LICENCIMI I SPORTISTËVE**

Çdo klub është i obliguar që një herë në vjet, të ripërtrijë licencën – anëtarësinë për çiklistet e saj në FÇK.

Me rastin e pagesës së anëtarësisë, shuma e të cilës caktohet nga Bordi i FÇK, vërtetimi i anëtarësisë dhe licencimi bëhet nga zyra e Federatës së çiklizmit të Kosovës. Shuma e pagesës së anëtarësisë për një vit garues është:

1. Licencimi për sportist-e/Sportiste 5 €,

## **NENI 14**

Sportisti i cili me dëshirën e vet e zgjedh klubin, regjistrimin për të mund ta bëjë prej moshës 14 vjeçare, nën kushte të parapara sipas kësaj rregulloreje, me ç ‘rast pranon obligimet, të drejtat dhe detyrat e parapara me akte normative të FÇK.

Për Sportistin nën moshën 18 vjeç, bashkëngjitur dokumentacionit për regjistrim, duhet të jetë edhe pëlqimi i njërit prej prindërve apo kujdestarit (Plotësohet Formulari).

## **NENI 15**

Asnjë Sportist nuk mund të regjistrohet për dy apo më shumë klube te çiklizmit në të njëjtën kohë.

Anëtarësia e Sportistit për një klub dokumentohet në bazë të regjistrimit paraprak.

Sportisti i cili në afat kalimtar e nënshkruan fletëregjistrimin për dy apo më shumë klube, me dokumentacion komplet apo jo komplet, e humb të drejtën e kalimit nga klubi amë dhe do të mbetet anëtar i tij deri në afatin e ardhshëm kalimtar dhe për këtë sanksionohet në bazë të dispozitave të Rregullores disiplinore të FÇK.

## **Neni 16**

### **REGJISTRIMI I SPORTISTIT PËR HER TE PARË**

Për Sportistin i cili për herë të parë regjistrohet, klubi i cili dëshiron ta regjistrojë është i obliguar që Komisionit për regjistrim t'ia paraqesë këtë dokumentacion (formulari):

- Fletëkërkesën e Sportistit, së cilës duhet bashkëngjitur;
- Kërkesën e klubit në formë të shkruar në dy kopje,
- Certifikatën e lindjes,
- Dy fotografi të madhësisë 3x4 cm, jo më të vjetra se gjashtë muaj,
- Vërtetimin mbi pagesën e bërë prej 5 euro në xhirollogari gjegjëse të FÇK.
- Nëse sportisti-ja është nën moshën 18 vjeqare bashkëngjitur dokumentacionit për regjistrim, duhet të jetë edhe pëlqimi i njërit prej prindërve apo kujdestarit.

## **NENI 17**

Regjistrimin e sportistëve të klubeve në FÇK e bën Komisioni për regjistrim, i emëruar nga Bordi i FÇK.

## **NENI 18**

Komisioni për regjistrimin e sportistëve është i obliguar që ta shqyrtojë dokumentacionin e kompletuar më së largu në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, përkatësisht nga dita e kalimit të afatit kalimtar.

Klubi, përkatësisht Sportisti që nuk e parashtron dokumentacionin e kompletuar duhet të udhëzohet që në afat prej 5 ditësh ta kompletojë atë, në të kundërtën kërkesa do të refuzohet.

#### **NENI 19**

Komisioni për regjistrim është i obliguar që pas shqyrtimit të kërkesave për regjistrim, me shkrim ta njoftojë administratën e FÇK në mënyrë që ajo ta bëjë regjistrimin e sportistëve, si dhe atyre t'ua lëshojë librezat garuese, duke i evidencuar në librin e evidencës.

#### **NENI 20**

Çdo regjistrim dhe licencim i anëtarëve të Federatës së çiklizmit të Kosovës duhet të vertetohet me vulën e FÇK.

#### **Neni 21**

Formën dhe përmbajtjen e librezës garuese e përcakton me akt të posaçëm Bordi i FÇK sipas rregullores së UCI-it

#### **Neni 22**

Në qoftë se librezat garuese humbet apo bëhet e pavlefshme, klubi i drejtohet administratës së FÇK-së për ta lëshuar duplikatin e saj.

#### **NENI 23**

Çiklisti nuk mund të përfshihen në aktivitetet sportive brenda klubit nëse nuk është vërtetuar nga mjeku, aftësia e tij për të kryer aktivitete fizike sportive, në përputhje me këtë sport.

#### **NENI 27**

Klubi duhet të organizohet në mënyrë të tillë që të siguroj monitorim të vazhdueshëm mjekësor të të gjithë çiklistëve të regjistruar në klub.

#### **NENI 25**

### **TRAJNERET**

1. **Trajner i çiklizmit** i cili ka një leje pune (licencë) – bazike ose profesionale

- mund të jetë i angazhuar në bazë të kontratës ose baza të tjera klub të çiklizmit.
2. Puna profesionale arsimore (shkollore) në fushën e çiklizmit mund të kryhet vetëm nga profesionistët të cilët kanë arsimin e duhur apo nivelin e duhur të kompetencave në fushën e edukimit fizik dhe të sportit.
  3. Nëse specialisti sportiv është i angazhuar në punën me fëmijët, duhet të kenë një arsim të duhur në fushën e sportit dhe edukimit fizik.

## **NENI 26**

### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

(Vlefshmëria e rregulloreve)

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas aprovimit nga Bordi i FÇK. Me hyrjen e saj në fuqi pushon të vlejë të gjitha aktet normative të FÇK-së që kanë të bëjnë me licencimin, si dhe të gjitha rregullat dhe praktikrat në lidhje me dhënien e licencës së klubeve çiklizmit të cilat ishin të aplikueshme në periudhën para miratimit të kësaj Rregulloreje.
2. Interpretimi i dispozitave të kësaj rregulloreje në mes të dy seancave të Bordit të FÇK-së e bënë Komisioni për licencimin e klubeve i FÇK-sësë bashku me përfaqësuesin zyrtar të Federatës.

Prishtinë

19.11.2022

Kryetari i FÇK

Avni Nuha

.....